

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaBond®-50 Parquet

ADEZIV ELASTIK PËR SHTRIMIN E DYSHEMEVE PREJ DRURI



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaBond®-50 Parquet është adeziv për shtrimin e dysHEMEVE prej druri me 1 përbërës dhe pa tretës.

PËRDORIMET

SikaBond®-50 Parquet është krijuar për ngjitjen e të gjithë sipërfaqes së dysHEMEVE prej druri inxhinierik (shirita, panele), parket mozaik dhe industrial, sisteme dysHemesh me pllaka zdrukthi dhe nëndysHEME. SikaBond®-50 Parquet është krijuar për përdorim mbi shumicën e llojeve të zakonshme të dysHEMEVE prej druri.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Adezivi mund të smerilizohet
- DysHEMEJA mund të smerilizohet pas 12 orësh
- Vetë elastike dhe amortizuese të zhurmave të hapave
- I përshtatshëm për përdorim për ngrohje nën dysHEME
- Redukton transferimin e sforcimit midis dysHEMESË prej druri dhe nënshtresës

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EMICODE EC1^{PLUS} R
- LEED® EQc 4.1
- SCAQMD, Rregulli 1168
- BAAQMD, Rreg. 8, Rreguli 51

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliuretan
Ambalazhi	kovë metalike 17 kg kuti kartoni 18 kg (3 x qese 6 kg)
Ngjyra	kafe parketi
Jetëgjatësia	SikaBond®-50 Parquet ka jetëgjatësi prej 12 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin original, të padëmtuar dhe të mbyllur dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.
Kushtet e magazinimit	SikaBond®-50 Parquet duhet të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C.
Dendësia	~ 1.60 kg/l (ISO 1183-1)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~ 40 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~ 0.7 N/mm ²	(ISO 37)
Zgjatimi deri në thyerje	~ 200%	(ISO 37)
Rezistenca ndaj prerjes	~ 0.6 N/mm ² , 1 mm trashësi adezivi	(ISO 17178)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	<p>Ngjitje e plotë e sipërfaqes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 800–1000 g/m² me mallë krëhër B3 (TKB Germany) p.sh. parket laminat, mozaik dhe industrial. ▪ 900–1200 g/m² me mallë krëhër B6 (TKB Germany) ose SC+ MB (US Standard) p.sh. për shirita druri dhe dërrasa inxhinierike, parket laminat dhe mozaik. ▪ 1000–1300 g/m² me mallë krëhër B11 (TKB Germany) ose P5 (US Standard) p.sh. dru solid, shirita të gjatë dhe panele inxhinierike, parket industrial, dysheme druri dhe shtrime të tjera rezidenciale, pllaka zdrukthi. <p>Për ngjitje të pllakave të gjata ose të gjera, ose kur punoni mbi nënshtresa të paniveluara, mund të nevojitet përdorimi i një malle krëhër me dhëmbëza më të mëdha për të siguruar se është aplikuar një sasi e mjaftueshme e SikaBond®-50 Parquet për të ofruar një sipërfaqe të njëtrajtshme adezivi dhe për të parandaluar pjesët bosh p.sh. pa ngjitje të plotë të sipërfaqes.</p> <p>Për nënshtresat e lyera me prajmerin Sika® Primer MR Fast ose Sika® Primer MB, konsumimi i SikaBond®-50 Parquet mund të reduktohet.</p>
Rrjedha e varjes	SikaBond®-50 Parquet përhapet shumë lehtë ndërsa ruan shenja të qëndrueshme të mallës.
Temperatura e mjedisit	+15 °C deri në +35 °C
Lagështia relative e ajrit	40% deri në 70%
Temperatura e nënshtresës	Gjatë shtrimit dhe derisa SikaBond®-50 Parquet të jetë tharë plotësisht, nënshtresa dhe temperaturat e ambientit duhet të jenë midis +15°C dhe +35°C pa dhe midis +20°C dhe +35°C me ngrohje nën dysheme.
Lagështia e përmbajtjes së nënshtresës	<p>Përmbajtja e lejueshme e lagështisë pa ngrohje nën dysheme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 2.5 % CM për llaçe dyshemeje çimentoje. ▪ 0.5 % CM për llaçe dyshemeje anhidriti. ▪ 3–12 % CM për dysheme magnetiti (në varësi të përmbajtjes organike). <p>Përmbajtja e lejueshme e lagështisë me ngrohje nën dysheme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1.8 % CM për llaçe dyshemeje çimentoje. ▪ 0.3 % CM për llaçe dyshemeje anhidriti. ▪ 3–12 % CM për dysheme magnetiti (në varësi të përmbajtjes organike). <p>Shënim: Për të gjitha përmbajtjet e lagështisë, cilësinë e nënshtresave dhe sipërfaqeve, ndiqni gjithmonë udhëzimet e prodhuesit të lëndës drusore.</p>
Ritmi i maturimit	~ 4.5 mm/24 orë (23 °C / 50% lagështi relative)
Koha e krijimit të kores / Koha e shtrimit	~ 60 minuta (23 °C / 50% lagështi relative)

UDHËZIME APLIKIMI

Për aplikimin e SikaBond®-50 Parquet vlejnjë të gjitha rregullat e pranuar të ndërtimit.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi referohuni tek Method Statement "Ngjitje e sipërfaqes së plotë".

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

- Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vajra, graso, pluhur, grimca të lira dhe të shkrifëta. Boja, korja e çimentos dhe kontaminues të tjerë që ndikojnë tek ngjitja duhet të hiqen.
- Betoni dhe/ose llaçet e çimentos duhet të bluhet dhe të pastrohen me një fshesë thithëse.
- Llaçet e anhidritit, duke përfshirë llaçe të rrjedhshëm

anhidriti duhet të bluhet dhe të pastrohen me fshesë thithëse industriale pak përpara nisjes së ngjitjes.

- Mastiku i asfaltit me spërkatje, duhet të lyhet me prajmerin Sika® Primer MB. Për udhëzime përdorimi, ju lutemi referohuni në skedën teknike përkatëse.
- Pllakave me glazurë dhe pllakave ekzistuese të vjetra qeramike duhet t' u hiqet grasoja dhe të pastrohen me Sika® Aktivator-205, ose sipërfaqet me pllaka duhet të jenë të bluara dhe të pastruara me fshesë thithëse industriale.
- Pllakat e drurit dhe/ose gipsit (p.sh. pllaka zdrukthi, kompesata) duhet të ngjiten dhe/ose vidhosen tek nënstruktura në mënyrë që të fiksohen mbi nënshtresë. Për dyshemetë e thata lundruese, kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.
- Për nënshtresa të tjera, kontaktoni me departamentin teknik për asistencë dhe konsulencë.

- SikaBond®-50 Parquet mund të përdoret pa prajmer mbi dysheme me bazë çimentoje, dysheme anhidriti, pllaka zdrukthi, pllaka betoni dhe qeramike.
- Për mastikun e asfaltit të spërkatur, dyshemetë me bazë çimentoje me përmbajtje të tepërt lagështie dhe përdorim mbi mbetje të vjetra adezivi ose mbi nënshtresa të dobëta, përdorni Sika® Primer MB. Për udhëzime të detajuara kontaktoni me departamentin teknik.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

SikaBond®-50 Parquet aplikohet direkt nga kova mbi nënshtresat e përgatitura saktë dhe përhapet në mënyrë të njëtrajtshme me mallë të dhembëzuar. Shtypni pjesët e dyshemesë prej druri tek adezivi që pjesa e poshtme e drurit të mbulohet plotësisht me adeziv. Pjesët mund të bashkohen me çekiç dhe tako. Shumë lloje dyshemesh prej druri duhet të goditen lehtë nga sipër. Duhet të ruhet një distancë prej 10–15 mm nga muri tek dyshemeja prej druri.

Mbi dysheme mund të ecet dhe/ose mund të smerilizohet 12 deri 24 orë pas instalimit (23 °C / 50% lagështi relative deri në 1 mm trashësi adezivi në varësi të kushteve të mjedisit dhe trashësisë së shtresës së adezivit).

Adezivi i freskët dhe i patharë mbi dyshemenë prej druri duhet të pastrohet menjëherë me një copë të pastër dhe nëse nevojitet me Sika® Remover-208. Testoni gjithmonë sipërfaqet e dyshemeve prej druri për pajtueshmëri me Sika® Remover-208 përpara përdorimit.

Duhet të zbatohen udhëzimet e prodhuesit të dyshemesë prej druri.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208 dhe/ose Sika® TopClean T. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Fleta e të dhënave të sigurisë
- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin & ngjitjen
- Method Statement "Ngjitje e plotë e sipërfaqes"

KUFIZIME

- SikaBond®-50 Parquet është i përshtatshëm për përdorim vetëm nga aplikuesit profesionalë të dyshemeve prej druri.
- Mos përdorni SikaBond®-50 Parquet për shirita masivi më të gjëra se 100 mm dhe më të gjata se 1200 mm.
- Për punueshmëri të mirë, temperatura e adezivit duhet të jetë $\geq +15$ °C.
- Për tharjen e duhur të adezivit, nevojitet lagështi e mjaftueshme ambienti.
- Përpara shtrimit të dyshemeve prej druri në zona të paizoluara, si bazamentet apo zona të tjera pa membranë hidroizoluese, duhet të aplikohet Sikafloor® EpoCem dhe të izolohet me Sika® Primer MB për kontroll të lagështisë. Për udhëzime të detajuara, kontaktoni me departamentin e shërbimit

teknik.

- Për përdorim me lloje dyshemesh me trajtim paraprak kimik (p.sh. ato të prodhuara ose të trajtuara me amoniak, bojë druri, konservues druri) dhe dërrasa me përmbajtje vaji relativisht të lartë, SikaBond®-50 Parquet duhet të përdoret vetëm miratimin me shkrim nga departamenti ynë i shërbimit teknik.
- Të mos përdoret mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon) dhe materiale të tjera të ngjashme sintetike të plastifikuara.
- Disa prajmera të tjerë dyshemeje mund të ndikojnë negativisht ndërkapjen e SikaBond®-50 Parquet (rekomandohen testime paraprake).
- SikaBond®-50 Parquet është krijuar si një adeziv për ngjitjen e dyshemeve prej druri. Gjatë shtrimit të dyshemeve prej druri të tipit parket pa bashkime femër-mashkull, p.sh. dysheme parketi mozaik, shmangni daljen e adezivit jashtë bashkimeve ndërmjet pjesëve prej druri.
- Shmangni kontaktin e çdo lloj izoluesi për sipërfaqet prej druri dhe adezivit. Megjithatë, nëse kontakti i drejtpërdrejtë është i pashmangshëm, atëherë duhet të kontrollohet dhe konfirmohet pajtueshmëria përpara përdorimit të veshjeve. Për informacione dhe këshilla të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me departamentin teknik.
- Mos ekspozoni SikaBond®-50 Parquet e patharë ndaj produkteve që përmbajnë alkool, pasi mund të ndikojnë në reaksionin e maturimit.
- Për informacione dhe këshilla të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me departamentin teknik.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaBond®-50 Parquet

Mars 2019, Botimi 01.01

020512010000000026

SikaBond-50Parquet-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf